

Përmbytjet, Panariti: Synojmë rigjallërimin e shpejtë të bujqësisë



Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Edmond Panariti ka folur për situatën e përmbytjeve dhe dëmet që ka sjellë në bujqësi. Panariti në fjalën e tij tha se synojnë të rigjallërojnë së shpejti bujqësinë.

Qeveria shqiptare ka marrë përsipër kreditë e rreth 1000 familjeve të përmbytura në jug të vendit, me një vlerë prej 1.5 milion euro. Në një vjetorin e USAID, Panariti tha se është marrë kjo masë për të nxitur aplikimin e kredive të reja që familjet në zonat e përmbytura në jug të vendit të kalojnë situatën e vështirë.

“Bujqësia vazhdon rritjen e saj, pavarësisht se ekonomia e vendit përballet me sfida dhe vështirësi. Kërkohen përpjekje të mëtejshme në fushën e investimeve, programi “Agro Kapital” është i rëndësishëm. Kërkohet dhe pjesëmarrja e sektorit bankar dhe dhënia e kredive. Këto fonde janë dhe një katalizator dhe për procesin e kreditimit. Shikojmë shenja të gjallërimit në kredi, por ka qenë shumë i ulët kohë më pare megjithëse e ka marrë veten. Kaluam një periudhë të vështirë nga përmbytjet në bujqësi. Falenderoj ndërkombëtarët për solidaritetin, biznesin dhe individë të veçantë gjithashtu kanë bërë që ta përballojmë me sukses këtë situatë”, deklaroi Panariti.

Projekti i USAID “Agro Kapital” përfshin dhënien e 18.5 milion dollarë investime që sipas ministrit do të krijojnë 1150 vende të reja pune. Ministri Panariti gjithashtu theksoi se qeveria ka hequr skemat klienteliste e tani në këtë sektor ka gjithëpërfshirje. Ndërkohë ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu ka shprehur keqardhje për familjet e prekura nga përmbytjet. Ai siguroi se SHBA do të vazhdojë me mbështetjen.

“Keqardhje për familjet e shumta shqiptare që kanë humbur fermat dhe bagëtinë e tyre nga përmbytjet. Shpresojmë që ndihma amerikane do t'i mbështesë këto familje e do ndihmojë këto zona. Përmbytjet nuk kanë dëmtuar vullnetin e shqiptarëve. “Agro Kapital” po ndihmon shumë ferma bujqësore. Ka ende shumë biznese për ndihma. Nevojiten ligje për ta bërë sektorin kredidhënies më transparent”, deklaroi Lu.